



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 685, datë 20.11.2024

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...},
PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,
PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 20.11.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Markelian Koça, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatës znj. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} është candidate për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 16.05.2024, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit dhe është përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr.732/1 prot., datë 17.05.2024 (protokolluar në Këshill me aktin nr. 2783 prot., datë 20.05.2024).

2. Me Vendimin nr. 264, datë 24.05.2024, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025*, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...} si relator u caktua z. Markelian Koça.

3. Më datë 27.05.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditör, kandidatja, znj. {...} depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 03.06.2024, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates, znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidatja, znj. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 11.06.2024, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidatja në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e saj në punë (punësimin) si dhe në ato të marra nga organet e sigurimeve shoqërore (me Shkresën nr. 6676/1 prot., datë 21.06.2024, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatës znj. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten {...}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 12.11.2024, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 12.11.2024 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose skualifikimin e kandidatës {...} për në formimin fillestar për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

12. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidaten {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30¹ (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i

¹ “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose

kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 16.05.2024, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidatja {...}.

13. Gjithsesi, për kandidaten {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

13.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2024), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (Prill 2024), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2024). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

13.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”), pika 4/1², shkronja “ç”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkaku përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

14. Konkretisht, për kandidaten u verifikua:

kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe aktet nënligjore përkatëse".

² “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”.

a) *zotësia e plotë për të vepruar.* Për kandidaten nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *shtetësisë shqiptare.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar dokumentin “Letërnjoftim”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 08.09.2016, në të cilin përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, pasqyrohet “shqiptare”, ndërkohë që gjatë verifikimit për kandidaten nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) *gjendja gjyqësore.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “vërtetim i gjendjes gjyqësore” e (Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike që mban datën 21.01.2024, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidates, u administruan Shkresa nr. 3174/3 prot., datë 25.06.2024, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidatja nuk ka shënime në sistem;

ç) *disiplina në punë.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “librezë punë”, lëshuar më datë 01.02.2017, ndërkohë që gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr. 963/1 prot., datë 19.06.2024 e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës; Shkresa nr. 3203/5 prot., datë 01.07.2024 e personit fizik Av. {...}; Shkresa nr. 3203/4 prot., datë 25.06.2024 e shoqërisë “Nexhi Law & Consulting ShPK” Av. {...} Sipas këtyre dokumenteve kandidatja nuk ka masë disiplinore në fuqi;

d) *mosqenia bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 14.02.2024 në të cilën deklaron se nuk ka qenë bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidates bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.

15. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) *pasjen e kriterit arsimor.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar dokumentet: Diplomë Bachelor nr. 14263 datë 20.01.2014 në degën Drejtësi e lëshuar nga Universiteti i Tiranës si dhe vërtetim notash e datë 10.10.2013; Diplomë Master i shkencave “E Drejtë Penale” nr.1088 lëshuar më datë 03.06.2016 e lëshuar nga Universiteti i Tiranës si dhe vërtetim notash e datë 28.07.2015;

b) *pasjen e përvojës profesionale.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “Librezë pune”, sipas të cilit kandidatja, pas përfundimit

të studimeve universitare në drejtësi, ka përvojë profesionale aktive në sektorin publik dhe atë privat, në profesionin “specialiste”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, për periudhën prill 2021 e në vijim ; në profesionin “koordinatore/avokate”, në shoqërisë “Nexhi Law & Consulting ShPK”, për një periudhë shtator 2017-shtator 2018 vijim ; në profesionin “avokate”, në Av. {...}”, për një periudhë prill 2019-dhjetor 2020.

c) *mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 14.02.2024, në të cilën deklaron se nuk është anëtare e ndonjë partie politike;

ç) *mosqenien anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë në datë 14.02.2024, në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së saj (e datëlindjes 02.06.1992), ajo nuk mund të ketë qenë e tillë.

B. Për kriterin e pasurisë

16. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *“1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë ...”*.

17. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet publike kompetente të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit. Ky raportim u kërkua vetëm për kandidaten, në kushtet kur ajo nuk ka “person të lidhur” në kuptim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (nenet 3 dhe 5), si dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (neni 2).

18. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 139/23 prot., datë 17.09.2024.

18.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës pasurisë dhe interesave privatë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

18.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë të deklaruara nga kandidatja {...}, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

19. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

19.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 10791/13 prot., datë 01.08.2024 dhe nr. 13140/1 prot., datë 27.06.2024, ku për kandidaten {...} nuk rezultoi ndonjë e dhënë për aktivitete tregtare dhe nuk rezulton të jetë e regjistruar në organet tatimore.

19.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 13697/1 prot., datë 01.07.2024, ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

20. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por edhe institucionet e tjera të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar kësaj të fundit bërja e një kontrolli dhe raportimi shtesë.

21. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të pasurisë, patur parasysh për këtë përcaktimin e shkronjës “a”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit: *“4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë ... kur: a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; ...”*. Konkretisht, për kandidaten verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidatja ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;
- ç) deklarimi nga kandidatja i pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

C. Për kriterin e figurës

22. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *“1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të ... figurës”*.

23. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

24. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitetet të kundërligjshme.

25. Nga raportimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas shkresës nr. 922/1 prot., datë 27.06.2024, nuk rezultoi ndonjë informacion i vlefshëm për qëllimet e verifikimit për kandidaten znj. {...}.

26. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkua dhe plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 06.06.2024, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

27. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 3174/4 prot., datë 28.06.2024, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidaten Hygerta Hysaj pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

28. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) sipas shkronjës “c”, pika 14, e këtij vendimi, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke konkluduar se kandidatja: *-ka dorëzuar Formularin e Vetëdeklarimit me datë 06.06.2024;- formulari është regjistruar me numrin unik 000706;-vetëdeklarimi është publikuar në faqen zyrtare web të KLGJ-së; -në formular nuk ka deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së*

ndalimeve parashikuar me ligj.- nuk ka deklaruar gjeneralitete të tjera, të mëparshme.-Sektori i Gjendjes Civile, personi rezulton se (nuk ka ndryshime) në përbërësit e gjendjes civile.-Sektori i Gjendjes Gjyqësore, ka raportuar se personi rezulton (e padënuar) nga gjykatat penale shqiptare. - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

29. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 796/16 prot., datë 01.10.2024, protokolluar me aktin nr. 3186/65, datë 02.10.2024, përgjigjet zyrtare të prokurorive. Gjithashtu, mbi kërkesën e Këshillit, u administrua dhe përgjigja e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përcjellë me Shkresën nr. 9076/1 prot., datë 02.07.2024, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3186/31, datë 03.07.2024. Referuar përmbajtjes së informacioneve të administruara për kandidaten {...}, nuk rezulton që ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, që ajo të ketë qenë ose të jetë nën hetim, që ndaj saj të jetë caktuar ndonjë masë sigurimi ose që ajo të jetë dënuar me vendim jo përfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale.

30. Për verifikimin e figurës së kandidateve, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë dhe të gjithë Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm kanë kryer verifikimin përkatës, të cilat në kohë të ndryshme kanë përcjell pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacionin për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}. Sipas informacioneve të administruara, rezulton se “*omissis... znj. {...} nuk ka asnjë çështje të regjistruar apo vendim të dhënë në ngarkim të saj...omissis.*”

31. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të figurës, patur parasysh përcaktimet e shkronjave “b” dhe “c”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilave: “*4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të .. figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; ...*”. Konkretisht, për kandidaten verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të

kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;

- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;
 - ç) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë, bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me sjelljen etike dhe morale të saj, mbi të cilën të ngrihen dyshime për cenim të besimit publik në sistemin gjyqësor dhe, për rrjedhojë, mbi pranueshmërinë e saj për në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUZIONE

32. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

33. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kritere, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të

Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2024-2025.
2. Një kopje e arsytuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR